



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E DRAGASHIT  
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



---

Datë: 30.12.2024

## PROCESVERBAL

**Takimi II (i dytë) Publik me qytetarë për punën gjashtëmuajore të Kryetarit dhe ekzekutivit lokal  
I mbajtur më 26.12.2024 (e enjte)  
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Njoftimi për këtë Takim Publik është publikuar më 09.12.2024:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/12/Takimi-II-Publik-1.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/12/Takimi-II-Publik-2.pdf>

Në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/19XgmvN7xc/>

Boshnjakisht: [https://www.facebook.com/share/p/19zq\[jy\]Bdt/](https://www.facebook.com/share/p/19zq[jy]Bdt/)

Pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë gjithsej 34 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 4
2. Meshkuj: 30

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini.

**Bexhet Xheladini:** Të nderuar të pranishëm,

Më lejoni që t'ju shpreh falënderimin tim për pjesëmarrjen në Takimin e Dytë Publik me Qytetarë, të cilin ne si qeverisje lokale jemi të obliguar ligjërisht që ta mbajmë në gjashtëmujorin e dytë të vitit, për të raportuar lidhur me punën dhe aktivitetet e kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit lokal.

Andaj, kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes një pasqyrë të shkurtër për ecurinë e punëve dhe angazhimet që ka pasur Komuna e Dragashit gjatë vitit 2024.

Si rezultat i punës së përbashkët dhe bashkëpunimit të mirë brenda dhe jashtë institucionit, kemi arritur që shumicën e punëve dhe projekteve t'i realizojmë në bazë të Planit të paraparë të Punës.

Puna e Kryetarit, përkatësisht ekzekutivit të Komunës së Dragashit është zhvilluar përmes 8 drejtorive dhe shërbimeve përcjellëse të Komunës, në harmoni me legjislacionin, udhëzimet dhe Statutin e Komunës.

*Si Qeveri Komunale, për këto tri vite shqubemi dhe jemi krenarë:*

*Asnjë tender njëburimor për tri vite;*

*Asnjë rast korrupsjoni dhe hanjie;*

*Asnjë aktakuçë;*

*Asnjë i dënuar;*

*Tri herë Raporti i Auditorit jo i kualifikuar;*

*Tri herë fitues të Grantit të Performancës; dhe*

*Buxheti i investimeve kapitale i shpenzuar deri në 98%.*

### **Synimet tona politike në qeverisje janë:**

*Qeverisje të mirë, të përgjithshme, të qëndrueshme, të hapur me qytetarët, demokratike dhe të suksesshme;*

*Qeverisje me plane dhe shikim kohë e ardhmja;*

*Qeverisje që gjen zgjidhje, sado sfiduese dhe komplekse të jenë problemet;*

*Qeverisje me plane të qarta dhe ambicioze;*

*Qeverisje që përballet me guxim dhe kryen punë me dinamikë të lartë e nuk vonohet;*

*Qeverisje që vlerëson, motivon dhe mbështet talentin dhe të arriturat e qytetareve tanë të të gjitha shtresave;*

*Qeverisje ndërtuese që promovon gjithëpërfshirjen në vendimmarrje të forcave me ndikim në shoqëri, si: forcat politike, Kuvendin e Komunës, bashkësinë fetare, shoqërinë civile, bizneset, individët, të rinjtë dhe grupet e ndryshme të interesit;*

*Qeverisje energjike që mobilizon resurse dhe përfshin në veprime investuese e zhvillimore punën në partneritet;*

*Qeverisje për të gjithë pa dallim.*

### **Aktivitete të rëndësishme:**

*Edhe përgjatë këtij viti kemi vazhduar bashkëpunimin me institucionet e Republikës së Turqisë në Kosovë, ku kemi realizuar një sërë kërkesash tona, siç është Ultraçëri modern me tri sonda për nevojat e gjinekologes në QKMF, ndërtimi i Këndit të lojërave për fëmijë në oborrin e Shkollës "Fetah Sylejmani" në Dragash, pastrimin e shtretërve të lumenjve të dëmtuar nga vërshimet (në disa zona të caktuara) etj.;*

*Në fushën e Kulturës dhe Sportit kemi shapllur Thirrje publike për financimin e OJQ-ve lokale për organizimin e ngjarjeve të ndryshme kulturore dhe sportive të cilat janë organizuar me rastin e shënimit të datave të rëndësishme historike;*

*Përveç aktiviteteve tashmë tradicionale, sivjet kemi filluar edhe organizimin e Ekspozitës së Qenit Ilir të Sharrit, një aktivitet që synon promovimin dhe mbrojtjen e racës autoktone të Qenit Ilir të Sharrit;*

*Në kuadër të aktiviteteve kulturore, kemi shpërndarë mirënjohje dhe dhurata simbolike për dhjetëra pensionistë dhe veteranë të luftës, duke shprehur mirënjohjen dhe falënderimin tonë për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm në luftë dhe në paqe;*

*Në vendin ku është rrënuar shtëpia famëkeqe e policisë serbe në fshatin Bresanë, kemi përrunuar Parkun e Lirisë, një hapësirë e gjelbër dhe rekreative për banorët e këtij fshati;*

*Në bashkëpunime me UNDP dhe OJQ-në 'AVOKO' kemi lansuar Platformën Visit Dragash ([www.visitdragash.com](http://www.visitdragash.com)), e cila do të shërbejë si një dritare informative për turistët vendorë dhe të huaj, për t'u njohur me potencialet turistike të Komunës sonë;*

*Si Qeverisje lokale kemi filluar hartimin e politikave për fillimin e procedurave të një planifikimi më të mirë urban në qytezën e Dragashit, ku fillimisht do të fokusohemi në rregullimin e infrastrukturës ndërtimore të Tregu i Gjëlber dhe pastaj, në bazë të mundësive ligjore do të angazhohemi edhe për investime të tjera në zona të ndryshme të qytezës;*

*Në bashkëpunim me MKRS-në jemi duke u angazhuar që Komunën tonë ta bëjmë edhe me një Qendër kulturore Multifunkionale, e cila do të jetë një hapësirë ku do të përshihen Muzeu, Biblioteka, salla të koncerteve, salla sportive, zyra dhe hapësira të tjera për realizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe sportive;*

*Në fillim të këtij viti, me Ambasadën e Japonisë kemi nënshkruar një Marrëveshje për financimin (71 mijë euro) e ndërtimit të objektit të tipit të mbyllur për grumbullimin e mbeturinave në hyrje të fshatit Restelicë. Ky projekt është në realizim e sipër dhe pritet të përfitojnë 5 mijë banorë nga ky investim që do të ndikojnë drejtpërdrejt në ruajtjen e ambientit. Objekti është ndërtuar kurse është në pritje edhe procedura e prokurimit për 26 kontejnerë;*

*Komuna e Dragashit, në bazë të rezultateve preliminare nga MAPL-ja, këtë vitë ka dyfishuar pikët në Grantin e Performancës për vitin 2023, duke shënuar një progres të ndjeshëm sa i përket punës dhe angazhimit të qeverisjes lokale në të gjitha fushat;*

*Me organizatën ASB kemi nënshkruar një Marrëveshje bashkëpunim për implementimin e projektit “Përkerahja e integritetit të grave në zonat rurale”. Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje kemi themeluar Qendrën për Angazhim të Komunitetit të Grave, një hap tutje drejt mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të grave në Komunën tonë. Kjo qendër tashmë është funksionale dhe aty kanë filluar të mbahen aktivitete të ndryshme;*

*Në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, përgjatë gjithë kohës së organizimit të procesit të Regjistrimit të Popullsisë, kemi bashkëpunuar ngushtë dhe kemi ofruar mbështetjen tonë, si dhe kemi bërë informimin dhe sensibilizimin e qytetarëve për t'u bërë pjesë e regjistrimit të Popullsisë;*

*Komuna e Dragashit, në bashkëpunim me Organizatën OPFAKKOS ka organizuar për herë të parë aktivitetet sportive me personat me nevoja të veçanta, në përfaqëje që të angazhohemi në drejtim të integritetit të kategorive të ndryshme të shoqërisë;*

*Kemi vazhduar bashkëpunimin me KFOR-in dhe CIMIC-un Italian, ku këtë vit kemi pranuar si donacion disa kompjuterë dhe një printer multifunksional laserik për bibliotekat lokale në Dragash;*

*Kemi realizuar një takim me Këshillin Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive, ku përfaqësues nga fusha e sportit në Komunën tonë janë informuar për infrastrukturën ligjore që rregullon fenomenin e dukurive negative në ngjarjet sportive;*

*Me Agjencinë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim kemi krijuar raporte të bashkëpunimit, me qëllim të vendosjes së bazave elementare për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit në Komunën tonë;*

*Me rastin e 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas kemi pasur një sërë aktivitete për të reflektuar mbi rëndësinë e promovimit të të drejtave të grave dhe hartimit të politikave që synojnë përmirësimin e pozitës së grave në shoqërinë tonë;*

*Si Qeverisje lokale, kemi mbajtur disa takime për të diskutuar mbi adresimin e kërkesave dhe vërejtjeve tona që duhet të përfshihen në procesin e hartimit të Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri”. Duke qenë të vetëdijshëm se gjendja aktuale me PK “Sharri” po na shkakton shumë vështirësi në shfrytëzimin e mundësive për investime të ndryshme në Komunën tonë, ne kemi adresuar disa kërkesa tek autoritetet kompetente, në mënyrë që të krijohen kushtet ligjore për investime dhe të bëhet ridefinimi i disa zonave të Parkut Kombëtar “Sharri”. Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar Sharri tashmë është në fazën e konsultimit publik dhe së shpejti Ministria e Planifikimit Hapësinor do të organizojë edhe një takim konsultativ me qytetarët e Komunës sonë, ku secili prej nesh mund të japë sugjerimet dhe vërejtjet e veta lidhur me përmbajtjen e Planit;*

*Gjithashtu, Asambleja Komunale përmes një Vendimi e ka dhënë dritën e gjelbër për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, një dokument shumë i rëndësishëm i cili do të parashihet një sërë objektivash për zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Dragashit brenda një periudhe tetëvjeçare. Ne tashmë kemi nisur procedurat e tenderimit për hartimin e PZHK-së, i cili do të jetë një projekt dyvjeçar dhe do të kushtojë mbi 100 mijë euro;*

*Në bashkëpunim me Shoqatën Bëmirëse “Jetimat e Ballkanit”, kemi bërë shpërndarjen e 100 pakove ushqimore dhe 100 pakove higjienike për familjet në nevojë në Opojë dhe në Gorë, me rastin e festës së Fitër Bajramit;*

*Për procedurave të Ankandit publik, kemi kryer të gjitha obligimet ligjore për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës – sipërfaqeve afariste apo lokaleve;*

*Edhe këtë vit, në muajin prill kemi marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit dhe Sportit, së bashku me katër biznese lokale private nga sektori i hotelerizmit dhe turizmit, me ç’rast kemi prezantuar vlerat e trashëgimisë kulturore, bukuritë natyrore, ushqimet tradicionale, si dhe kapacitetet e shërbimit hotelier e turistik që ofron Komuna jonë;*

*Gjithashtu, në tetor të këtij viti, së bashku me katër biznese lokale kemi marrë pjesë në Panirin e Agrobiznesit, Ushqimit dhe Pijeve “AGROKOS”;*

*Kemi vazhduar edhe me Edicionin e tretë të Panirit me Produkte Vendore Lokale “EXPO SHARRI”, i cili tashmë është bërë një ngjarje e rëndësishme ekonomike për Komunën tonë, ku biznese të shumta promovojnë produktet e tyre vendore lokale;*

*Me Ministrinë e Infrastrukturës kemi nënshkruar Memorandum bashkëpunimi për financimin e projektit “Asfaltimi i rrugës Zlipotok-Baçkë-Brod”, në vlerë prej 350 mijë euro;*

*Kemi hartuar Planin trevjeçar të Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës, një dokument i rëndësishëm i cili parashihet aktivitetet që do të ndikojnë në parandalimin e fenomenit të braktisjes apo mosregjistrimit të nxënësve në shkollë;*

*Në maj të këtij viti kemi filluar Programin e vizitave sistematike shëndetësore të nxënësve nëpër shkolla;*

*Me organizatën japoneze JICA, kemi në bashkëpunim të vazhdueshëm për ecurinë e përgjithshme të reformës së sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën tonë;*

Këtë vit, Komuna e Dragashit ka qenë nikoqire e organizmit të Debatit mbi politikën në kuadër të Javës së Gruas, e cila organizohet çdo vit nga Instituti Kombëtar Demokratik. Përfaqësues të shumtë nga komunat e Regjionit të Prizrenit kanë marrë pjesë në këtë Debat, për të diskutuar për adresimin e çështjeve gjinore, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe politikën e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor në nivel lokal;

Në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, më 1 qershor të këtij viti, në bashkëpunim me organizatën “NEVO KONCEPTI” kemi themeluar Asambleenë e Fëmijëve, një platformë e cila do të shërbejë si një mundësi e mirë që zëri i fëmijëve të dëgjohet në të gjitha nivelet e vendimmarrjes;

Me Vendim të Asamblesë Komunale, një delegacion i Komunës së Dragashit ka realizuar një vizitë studimore në Itali, me ç'rast është vizituar Komuna San Vito al Tagliamento, për t'u njohur me funksionimin politik-administrativ të kësaj komune italiane, si dhe për të shkëmbyer praktika dhe shembuj pozitivë të politikave të menaxhimit në nivel lokal;

Në bashkëpunim me Down Syndrome Kosova, kemi hartuar Planin Komunal të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, një dokument i cili përmban objektiva të rëndësishme dhe aktivitete që ndikojnë në mirëqenien e përgjithshme të personave me aftësi të kufizuara në Komunën tonë;

Jemi angazhuar edhe në funksionalizimin e Zyrës së HANDIKOS-it në Dragash;

Për të rritur sa më shumë gjithëpërfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, kemi realizuar një sërë dëgjimesh buxhetore dhe konsultimesh publike, si për KAB-n dhe buxhetin final, ashtu edhe për dokumente dhe plane komunale të veprimit;

Me organizatën Tetra Tech ARD kemi nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit për zbatimin e përbashkët të Aktivitetit të USAID-it për Qeverisjen e Pronës. Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, kemi mbajtur edhe takim konsultativ me qytetarë dhe përfaqësues të bizneseve, për themelimin e Këshillit Publiko-Privat, si një mekanizëm i bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat;

Gjatë Muajit Rozë të Ndërgjegjësimit Kundër Kancerit të Gjirit, në bashkëpunim me Grupin e Grave Asambleiste dhe Zyren për Barazim Gjinor kemi zhvilluar aktivitete të ndryshme, takime dhe ligjërata vetëdijesuse më gratë dhe vajzat e Komunës sonë, për të rritur informimin dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e parandalimit të kancerit të gjirit;

Kemi nënshkruar Marrëveshje me Komunën e Studineçanit nga Maqedonia e Veriut, për aplikimin e përbashkët në Programin Ndërkufitar IPA;

Edhe këtë vit, mbi 100 (110 studentë) studentë nga Komuna jonë do të jenë përfutues të bursave komunale ku tashmë është publikuar Lista preliminare e studentëve përfutues potencialë të këtyre bursave;

Transporti falas për të gjithë nxënësit që vijnë në mësimin nëpër shkollat e Komunës së Dragashit;

Sa u përket subvencioneve në bujqësi, 257 fermerë nga Komuna jonë kanë përfutuar nga një shumë prej 90 mijë eurosh, nga Projekti për subvencionimin e ushqimeve për kafshë;

Në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëfinancim me OJQ “Advancing Together” planifikojmë të realizojmë disa projekte, siç janë Papa Testi për gratë, ofrimi i shërbimeve dentare për personat me aftësi të kufizuara, vendosja e lëkundësive në këndet e lojërave për fëmijë dhe dbomat etnologjike në Muzeun Komunal.

## ***Vërshimet e muajit qershor***

*Siç e dini, në muajin qershor të këtij viti që po e lëmë pas, Komuna e Dragashit është ballafaquar me disa vërshime të cilat kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme nëpër disa fshatra, si në ekonomi familjare, biznese, infrastrukturë publike dhe sipërfaqe bujqësore. Në bazë të kompetencave ligjore, si kryetar i Komunës dhe si qeverisje lokale kemi ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme qysh në fillim të gjendjes së krijuar nga vërshimet. Kemi bërë vlerësimin e menjëhershëm të dëmeve në infrastrukturë publike, ashtu siç kemi marrë rekomandimin nga organet qendrore. Kemi dorëzuar raportin për shumën totale të dëmeve të vlerësuara. Mirëpo, pavarësisht kësaj, ne ende nuk kemi marrë ndonjë ndihmë nga Qeveria qendrore për riparimin e infrastrukturës publike. Rrjedhimisht, ne jemi detyruar që të bëjmë anulimin e disa tenderëve të planifikuar për këtë vit, dhe paratë e planifikuara për ato projekte t'i orientojmë në riparimin e infrastrukturës së dëmtuar nga vërshimet.*

*Gjithashtu, ne menjëherë kemi formuar Komisionin Lokal për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, i cili ka bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomi familjare, biznese dhe bujqësi. Komisioni ka pranuar gjithsej 227 kërkesa nga qytetarët dhe të gjitha i ka shlyrtuar. Raportin përfundimtar e ka dërguar në Asamble Komunale për miratim dhe pastaj e ka proceduar në Komision Qendror qeveritar për Vlerësimin e Dëmeve.*

## ***Investimet Kapitale***

*Sa u përket investimeve kapitale, Komuna e Dragashit përgjatë vitit 2024 e ka realizuar në masë të konsiderueshme Planin e Prokurimit. Kemi nënshkruar mbi 100 kontrata për realizimin e projekteve të ndryshme nëpër të gjithë territorin e Komunës sonë, të cilat lidhen kryesisht me modernizimin e infrastrukturës publike nëpër institucione shëndetësore dhe arsimore, kubëzimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale, ndërtimin e infrastrukturës sportive etj. Disa nga projektet e rëndësishme të cilat mund t'i përmendim janë:*

*Ndërtimi i fushës së Stadiumit të Qytetit në Dragash;*

*Asfaltimi i rrugës Dragash – Stadium i Qytetit;*

*Nisja e punimeve për ndërtimin e Fabrikës së ujit në Radeshtë;*

*Ndërtimi i sallës së re sportive në oborrin e Shkollës Fillore në fshatin Bresanë;*

*Ndërtimi i objektit të ri të QMF-së në fshatin Krushevë;*

*Etj.*

## **Statistika nga Zyra Ligjore**

*Sa u përket vendimeve dhe lëndëve të miratuara dhe proceduara nga Zyra Ligjore dhe Zyra e Kryetarit, ajo që vlen të theksohet është se gjatë këtij viti kemi marrë gjithsej 393 vendime për lejimin e mjeteve nga subvencionet e Zyrës së Kryetarit. Nga mjetet e subvencioneve për shërim kanë përfituar mbi 370 qytetarë, ndërsa një pjesë tjetër e subvencioneve nga Zyra e Kryetarit janë dedikuar për raste të ndryshme, si për botime të librave, për aktivitete të OJQ-ve, mbështetje të familjeve strehuese, familjarëve të dëshmorëve, për personat me nevoja të veçanta, organizime të turnireve etj.*

*Gjatë vitit për të cilin po raportojmë kemi nënshkruar kontrata të ndryshme, memorandume të mirëkuptimit, marrëveshje për bashkëfinancim etj., me organizata dhe institucione të ndryshme, të cilat kanë për qëllim përmirësimin dhe ngritjen e mirëqenies për qytetarët e Komunës sonë.*

*Gjithashtu, kemi drejtuar edhe kërkesa të ndryshme në adresë të organizatave vendore dhe ndërkombëtare, si dhe institucione të Qeverisë qendrore, ku kemi paraqitur nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe të Komunës së Dragashit.*

### **Prioritetet tona kryesore për Dragashin vazhdojnë të jenë:**

*Administratë efikase, e përgjithshme dhe me shërbime moderne;*

*Organizim më i mirë i punës dhe efikasitet i plotë i administratës së Komunës;*

*Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit;*

*Realizim i planit të të hyrave të Komunës;*

*Rritja e përkrahjes për bujqësinë dhe për fermerët;*

*Furnizimi me ujë të pijshëm;*

*Zhvillimi i turizmit dhe ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse;*

*Nxatje të investimeve dhe projekteve në turizëm;*

*Trotuare dhe shtigje të ecjes për këmbësorë dhe biçiklistë;*

*Investime për ndriçim publik;*

*Rritje e cilësisë dhe investime në arsim;*

*Investime në nyje sanitare dhe meremetim të shkollave;*

*Bursa për studentë;*

*Hartimi i PZbK-së dhe Hartës zonale;*



*Terrene të reja sportive dhe përkrahje e sportit, aktivitete të planifikuara me të rinjtë;*

*Krijimi i kushteve të përshtatshme për investime të drejtpërdrejta për të mirën e qytetarëve përmes krijimit të vendeve të përbashme të punës si dhe zhvillimit ekonomik;*

*Bashkëpunimi i vazhdueshëm me kompanitë publike për shtimin e kapaciteteve për ujë të pijes dhe për shërbime më efektive në grumbullimin e mbeturinave për një ambient sa më të pastër dhe futjen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave për fshatrat që ende nuk janë të kyçura në sistem;*

*Bashkëpunimi me komunitetin fetar, shoqëritë civile OJQ ndërkombëtare, vendore dhe partner të tjerë.*

Faleminderit! Para se t'ju jap fjalën juve, shfrytëzoj rastin t'i falënderoj drejtorët dhe të gjithë stafin komunal, të gjithë punëtorët e Komunës, të institucioneve në arsim dhe shëndetësi, të cilët me punën e tyre me përkushtim i kanë kryer të gjitha obligimet që i kanë marrë nga udhëheqësit e tyre. Si pasojë e punës së përbashkët, ne sot jemi ndër komunat më të suksesshme në Kosovë. Nëse ka dikush që dëshiron ta marrë fjalën, urdhëroni! **Bekim Qusaj, banor i Dragashit:** Përshëndetje për kryetarin dhe të pranishmit e tjerë që gjenden në këtë sallë! Unë Bekri Qusaj, kryetar i Bashkësisë Lokale të Dragashit, do të tregoj për investimet që janë bërë në qytezën tonë, të cilat kanë qenë kërkesë e qytetarëve të Dragashit. Rrjeti i ujësjellësit përbrenda qytezës, në tërësi i përfunduar me sukses; Rrjeti i ujësjellësit të fshatit Pllavë, në drejtim të fshatit Shajne, ku kishim shumë defekte, i rregulluar dhe i vendosur gypi i ri në gjatësi prej 1370 m; Kanalizimi në katër lagje të qytezës, i përfunduar me sukses; Në katër lagje ku ka qenë i shtrirë kanalizimi, kemi bërë edhe shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit dhe është i përfunduar me sukses; Rregullimi dhe lysterja përbrenda objektit të KRU – Njësia Punuese në Dragash, Hidroregjioni Jugor, një zyrë e punuar, në tërësi e suvatuar, me të gjitha që ka pas nevojë. Tri zyra tjera, koridori, shkallët, krejta të rrëgulluara, të pastruara, të lysterja me ngjyrë të bardhë, investim direkt i Zyrës së kryetarit, z.Bexhet Xheladini. Na ka bërë një punë shumë të mirë, një ndihmë shumë të madhe; KRU – Njësia Punuese në Dragash, pasi edhe jam punëtor i kësaj kompanie, është mirënjohëse për ndihmën që na ofruar shumë herë, edhe në fushën e defekteve që kemi pasur në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, ku edhe është ofruar ndihma me anë të bagerit. Ka qenë direkt i kyçur edhe kryetari, ka kontaktuar të gjitha ato firma që kanë punuar te ne, kush ka pas mundësi me na ndihmue, edhe është realizuar qindpërqind defekti edhe veprimtaria në atë rrjet. Kryetar, e di se janë të shumta kërkesat e qytetarëve, nuk janë vetëm tonat. Ne si qytetarë, kërkesat që i kemi pas për Zyrën tuaj, për Komunën, i kemi të realizuara 100% përbrenda qytezës në Dragash. Edhe këtë vit edhe vitet paraprake jemi të kënaqur me punën.

Por, si punëtor i KRU-së, e kemi edhe një kërkesë, sipas mundësive që mundeni me e realizue në të ardhmen, sipas financave qysh i keni mundësitë. Kemi shumë nevojë për një bager. Bagerin e kemi në defekt. E di, keni kërkesa edhe ma serioze, nga ana e qytetarëve me sëmundje të ndryshme, por edhe kjo është një kërkesë e jona, sepse Regjioni në Prizren nuk munden me na ndihmue, nuk janë në gjendje me e hap një tender për blerje të bagerit. Kështu na kanë lënë me një bager defekt, ku shumicën e rasteve thuajse këtë vit, të gjitha ndërhyrjet me ndihmën e juaj i kemi realizuar, duke na gjet mënyra të ndryshme, bagera, me investimet e Komunës. Kështu që, shumë kemi nevojë për këtë bager. Nëse të jepet mundësia, kryetar, në të ardhmen, brenda këtij viti, me e realizue, do të ishim shumë mirënjohës. Edhe jemi duke e shti rrjetin e ujësjellësit, vetë je duke punue në këtë projekt që u ndalue edhe s'ka pas mundësi kush me e vazhdue, je i vetmi që je duke e vazhdue edhe je duke e realizue. Atëherë, t'u kisha lut, me e marrë si kërkesë tonën, në të ardhmen, brenda këtij viti me na realizue. Faleminderit shumë!

**Bexhet Xheladini:** Falënderoj përfaqësuesin e Hidroregjionit! Sa i përket kërkesës për blerjen e një ekskavatori për nevojat tuaja, ne për momentin nuk mundemi me ju dhënë fjalë edhe me premtue, por do të mundohemi që përmes donatorëve, investitorëve, ta bëjmë një kërkesë të tillë. Riparimin e ekskavatorit të vjetër, atë mund ta bëjmë me mjetet tona, kemi aq pare. Për riparim mundemi, për blerje të ekskavatorit të ri nuk mundemi me premtue asgjë.

**Amra Zaimi, gazetare RTK:** Përshëndetje për të gjithë, unë jam Amra Zaimi. gazetare dhe shpeshherë jam në kontakt me qytetarët, desha ta bëj një pyetje lidhur me grumbullimin e mbeturinave. Po e marr si shembull fshatin Radeshë, pasi që vij prej atij fshati, prej muajit nëntor deri në muajin mars-prill, kompania që është e angazhuar nuk vjen të bëjë grumbullimin, mbeturinat qendrojnë në rrugë e askush nuk vjen t'i marrë, pastaj ne detyrohemi që t'i sjellim në Dragash. Ndërsa, kur vjen puna te pagesa vijnë çdo muaj. Nuk e di se si mund të bëjnë pagesën për shërbimet të cilat nuk i kryejnë, a ka ndonje zgjidhje? Pasi që edhe pagesa ka qenë 4.5 euro, kurse tash 5.5 dhe shumë qytetarë ankohen pse ne vetë t'i sjellim mbeturinat në Dragash kur mund t'i gjuajmë në lumë, e pastaj le të mendojë se si do të veprojë ndërmarrja. Pra, Komuna duhet të gjejë ndonjë zgjidhje siç është në fshatrat si Brodi apo Restelica. Problemi vazhdon të jetë edhe gjatë verës, ku kemi edhe diasporën, pra është shumë pak që kompania të vijë një here në javë që të bëjë grumbullimin e mbeturinave, sepse qytetarët detyrohen të hedhin mbeturina nëpër hapësira të gjelbërta ku ka edhe shenja për ndalimin e hedhjes së mbeturinave. Pyetja ime e dytë ka të bëjë me disa emisione që unë kam bërë me rastet sociale në komunën tonë. Ka shumë donatorë tek ne, edhe ju e përmendet Jetimat e Ballkanit, mirëpo kur vjen puna tek dhënia e parcelave komunale për ndërtimin e shtëpive për këto raste, Komuna nuk jep parcela

për këto raste, edhe pse të gjithë e dimë se Komuna u ka dhënë parcela nëpër fshatra njerëzve të cilët kanë mjete që t'i ndërtojnë vetë shtëpitë. A mund të bëni ndonjë zgjidhje për këta?

**Bexhet Xheladini:** Sa i përket pyetjes së parë për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave, unë këtë informatë për herë të parë po e dëgjoj. Unë do të merrem me këtë çështje, do të bisedoj dhe me përfaqësuesin komunal të “Ekoregjionit”, por do të bisedoj edhe me Kryeshefin Ekzekutiv të “Ekoregjionit”, dhe këtë problem ne duhet me e zgjidhë patjetër. Ndërsa sa i përket pyetjes së dytë, me ligj Komuna nuk ka të drejtë më dhënë tokë të sajën për ndërtim të shtëpive. Kështu që, deri më tash qytetarët të cilët e kanë bërë këtë, ata i kanë uzurpue sigurisht pronat dhe e kanë bërë ndërtimin e tyre, përndryshe Kuvendi Komunal nuk mund të ndajë truall për ndërtim të shtëpive. Kjo është e ndaluar me ligj. Nëse bëhet ndonjë ndryshim për këtë çështje, ne jemi të gatshëm që këtë ta bëjmë. Ne si Komunë kemi vullnetin, por ligji është ligj dhe nuk mund ta shkelim.

Nëse nuk ka pyetje të tjera, atëherë ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe mirë u pafshim në takimet e radhës!

**Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:**

**Në uebfaqe:**

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/kryetari-xheladini-mban-takimin-e-dyte-publik-me-qytetare-per-vitin-2024/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/gradonacelnik-odrzo-je-danas-drugi-godisnji-sastanak-sa-gradjanima-za-2024/>

**Në Facebook:**

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/19sSg5m5RF/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1DxE44Wp2o/>

**SHTOJCË:** *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO**  
**KOMUNA E DRAGASHIT**  
**DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Data/Datum: 26.12.2024

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

**LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIMIN E DYTË PUBLIK ME QYTETARË**

**LISTA UÇESNIKA NA DRUGOM JAVNI SKUP SA GRAĐANIMA**

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivalište	Etnia Etnička pripadnost	M M	F Ž	Nënshkrimi Potpis
1	Behar Selmani	KUK	Shqiptar	M		<i>[Signature]</i>
2	BEHAR RAMADANI	KUPU	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
3	ARDIT KALAVOERI	KOSAVE	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
4	SHABAN SKEJDEH	BRUT	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
5	Sirhan Bajrami	BROD	bosni, Al	M		<i>[Signature]</i>
6	VETON HARIZI	ZAPLUXHE	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
7	Eëmalima Hegini	Dragash	Shqiptar	F		<i>[Signature]</i>
8	Kultrina LUSHIPI	BRZAP	Shqiptare	F		<i>[Signature]</i>
9	LIRIONA MERRAS	PLAVE	SHQIPTAR	F		<i>[Signature]</i>
10	Behar Quresh	DREGUL	Shqiptar	M		<i>[Signature]</i>
11	RESHAT ALIJA	BLAQ	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
12	MEHRODIN GARDENAT	RRENE	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
13	ALTON JENJUNJUKU	BLAQ	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
14	DALIP KODINA	BLAQ	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
15	Fitim SPATHU	DRAGASH	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
16	VAJDIR ADEMI	BRODOSANE	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
17	Erdi Ademi	BRODOSANE	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
18	VEJRI REGHIT	BREJAN	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
19	FLORENT LUFATI	BRODOSAN	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
20	Auriga Zajun	ZADESA	GORANAC	F		<i>[Signature]</i>
21	Gamil Kollozi	MEYER	Shqiptar	M		<i>[Signature]</i>
22	NEHAT TERSHOZANU	ORRE	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
23	DIBLAN AJU	BRUT	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
24	FETIJK VANDON	BRODOSANA	GORANAC	M		<i>[Signature]</i>
25	EDISON BEÇIRI	PRIZREN	GORANAC	M		<i>[Signature]</i>
26	DRAHIM SYLJEMANI	BRESANË	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
27	RINDAN JOMUZH	DILAVLIK	SHQIPTAR	M		<i>[Signature]</i>
28	AVDIF MUSA	KRESHTIC	KOSOVY	M		<i>[Signature]</i>

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**Komuna e Dragashit**  
**Opština Dragaš**

02 Nr. Br. 020/01-31311/24  
 26.12.2024  
 Dragash - Dragaš

29	Bojron Jus	Releto	Rehak	M		LC
30	Qarkin Zajnali	Shjane	Shqiptar	M		Qarkin
31	VLBER WELER	BZAC	SHQIPTAR	M		VLBER
32	Edisur Luani	Releto	Bosniac	M		Edisur
33	Samidin Xhelodini	Bresane	Shqiptar	M		Samidin
34	FARI KOLLONI	KOSAVE	Shqiptar	M		FARI
35						
36						
37						
38						
39						
40						
41						
42						
43						
44						
45						
46						
47						
48						
49						
50						
51						
52						
53						
54						
55						
56						
57						
58						
59						
60						
61						
62						
63						
64						
65						
66						
67						
68						
69						
70						



